



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 4.3.2024

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 442, datë 14.9.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, si dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 23.2.2024, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

1. Për shkaqet e parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021

1. Për procedimin penal me nr.***, datë **.6.2017, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e hetimit lidhur me këtë procedim penal për sa i përket: (i) verifikimit të shkaqeve që kanë sjellë kohëzgjatjen e hetimit nga momenti i regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë **.6.2017, deri në paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal, datë **.11.2020, referuar nenit 327 të K. Pr. P.; (ii) verifikimin e subjekteve, të cilëve u atribuohet vepra penale, regjistrimi i tyre referuar nenit 287 të K. Pr. P., dhe zbatimin eventual të dispozitës së nenit 75/a, lidhur me nenin 80, të Kodit të Procedurës Penale, në përcaktimin e kompetencës lëndore, në hetimin e procedimit penal, referuar edhe detyrave të lëna nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjyrokastër, në vendimin nr. **, datë **.2.2021.

1.1 Pas shqyrtimit të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. ***, datë **.6.2017, Komisioneri Publik, në seancën gjyqësore të datës 23.2.2024, ka konstatuar se, në hetimin e këtij procedimi penal të regjistruar më datë **.6.2017 dhe dërguar kërkesa për pushimin e procedimit penal më datë **.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, por duket se mbeten për t'u vlerësuar shkaqet eventuale që do të pretendohen edhe në këtë gjykim lidhur me një kohëzgjatje të tillë në rastin konkret.

1.2 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datën **.2.2024, regjistruar me nr. **/** prot., ndër të tjera, është shprehur se në kohëzgjatjen e hetimit të këtij procedimi penal kanë ndikuar: [...] a) kompleksiteti i caktuar i rastit (në njëfarë mase); b) detyrimi për kujdes në administrimin dhe zgjidhjen e drejtë të tij; c) faktorët objektivë të mangësive në organikën dhe situata e Covid-19; d) përpjekjet e arsyeshme dhe të shpeshta të subjektit të rivlerësimit për zgjidhjen e tyre çojnë në përfundimin se nuk ka patur një shkelje të afatit të arsyeshëm në rastin konkret [...]. Vërehet se subjekti i rivlerësimit shprehet edhe për aspektin ekonomik në çështjen konkrete, e cila rezulton e pacenuar në ndonjë mënyrë që të vlerësohte urgjencën në rastin konkret.

1.3 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, lidhur me kohëzgjatjen e hetimit, ka paraqitur shkresat që vërtetojnë ngarkesën, strukturën e kërkesat për shtim organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër.

1.4 Procedimi penal rezulton të jetë pushuar dhe nënshtruar kontrollit gjyqësor, vendim nr. ***/**, datë **.7.2022, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, vendim që rezulton të ketë marrë formë të prerë, i paankimuar nga palët.

1.5 Nga sa më lart, në hetimin e këtij procedimi penal, të regjistruar më datë **.6.2017 dhe dërguar kërkesa për pushimin e procedimit penal më datë **.10.2020, referuar dhe veprimeve hetimore të realizuara nga subjekti i rivlerësimit, duket se ky hetim është realizuar në tejkalim të afatit të arsyeshëm hetimor.

1.5.1 Lidhur me shkakun ankimor në lidhje me zbatimin e dispozitave penale të parashikuara nga nenet 75/a, 80 dhe 287 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioneri Publik iu qëndron parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 23.2.2024.

1.6 Për sa më lart, referuar nënindikatorëve të parashikuar nga neni 74, "Aftësitë organizative", të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të cilët shërbejnë në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit, në rastin konkret, gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive në raport me: (i) përballimin e ngarkesës në punë; (ii) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore; (iii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar.

2. Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale në ngarkim të shtetasit *** ***, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit nëse veprimet procedurale janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, dhe nëse është zbatuar në mënyrë korrekte legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale, konkretisht për: (1) vendimin penal nr. ***, datë **.10.2017, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, lënë në fuqi nga vendimi nr. **, datë **.3.2018, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, dhe (2) vendimin

nr.***, datë **.6.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër.

2.1 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datën **.2.2024, regjistruar me nr. **/** prot., ndër të tjera, është shprehur se: [...] *Rezulton se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit janë në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Penale me vendosjen në dispozicion të akteve, janë ndërmarrë veprime konkrete shumë shpejtë për nxjerrjen e urdhrave përkatës. Po kështu, edhe në nxjerrjen e urdhrave për shpalljen në kërkim ndërkombëtar, është vepruar në përputhje me këto përcaktime. Është vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.8831, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në lidhje me ushtrimin e detyrave nga subjekti i rivlerësimit. Është vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja në çështjet penale [...].*

2.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, lidhur me ekzekutimin e vendimit penal nr. ***, datë **.10.2017, dhe vendimit penal nr. ***, datë **.6.2019, vlerëson se konstatohet tejkalim të afateve vetëm me disa ditë¹, mangësi, të cilat, marrë në konsideratë rrethanat objektive të konstatuara, duket se janë jorelevante në nxjerrjen e urdhrave, duke mos cenuar në tërësi procedurën e ekzekutimit të këtyre dy vendimeve penale.

3. *Për procedimin penal nr.***/* i vitit 2017, në ngarkim të shtetasit *** ***, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit nëse është subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, prokurori i çështjes të procedimit penal nr. ***/*, viti 2017, dhe respektimit të afateve të hetimit të saj, në kuptim të nenit 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.*

3.1 Pas shqyrtimit të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. ***/* të vitit 2017, Komisioneri Publik, në seancën gjyqësore të datës 23.2.2024, ka konstatuar se, në hetimin e këtij procedimi penal, të regjistruar më datë **.6.2019 dhe dërguar kërkesa për pushimin e procedimit penal më datë **.1.2022, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, por duket se mbeten për t’u vlerësuar shkaqet eventuale që do të pretendohen edhe në këtë gjykim lidhur me një kohëzgjatje të tillë në rastin konkret.

3.2 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datën **.2.2024, regjistruar me nr. **/** prot., ndër të tjera, është shprehur: [...] *fakti që shumësi i veprimeve është kryer në kohë, shkallën jo të vogël të kompleksitetit, fakti që ka patur faktor objektiv² të përligjur, duke patur parasysh edhe mungesën e ngutshmërisë nga perspektiva e interesat në lojë dhe ekzistenca e mjeteve efektive, arrihet në përfundimin se afati i hetimit të kësaj çështje është i arsyeshëm [...].*

3.3 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, lidhur me kohëzgjatjen e hetimit, ka paraqitur shkresat që vërtetojnë ngarkesën, strukturën e kërkesat për shtim organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër.

¹ Referuar Udhëzimit të përbashkët “Për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”, e Ministrisë të Brendshme me nr. ***/* prot., datë **.6.2010, dhe Prokurorit të Përgjithshëm me nr. ** prot., datë **.6.2010.

² Në të njëjtat parashtrime citon si faktorë objektivë të pavarur nga vullneti i subjektit të rivlerësimit, mungesat e lëvizjet në organikë dhe reduktimin e veprimtarisë si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga Covid-19.

3.3.1 Nga sa më lart, rezulton se në hetimin e këtij procedimi penal, të regjistruar më datë ****6.2019** dhe dërguar kërkesa për pushimin e procedimit penal më datë ****1.2022**, referuar dhe veprimeve hetimore të realizuara nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se ky hetim është realizuar në tejkalim të afatit të arsyeshëm hetimor.

3.4 Edhe në këtë rast, referuar nënindikatorëve të parashikuar nga neni 74, “Aftësitë organizative”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të cilët shërbejnë në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit, në rastin konkret, gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive në raport me: (i) përballimin e ngarkesës në punë; (ii) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore, (iii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar.

4. *Për procedimin penal për veprën penale: “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ankimin e Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021, është parashtruar nevoja e një hetimi të mëtejshëm lidhur me verifikimin e ecurisë së procedimit penal për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në drejtim të sekuestros së pasurisë dhe vendimmarrjes eventuale të Gjykatës, gjatë kontrollit të këtij vendimi, gjatë kryerjes së veprimeve hetimore.*

4.1 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datën ****2.2024**, regjistruar me nr. ****/**** prot., ndër të tjera, është shprehur: [...] *Lidhur me realizimin e sekuestros nga prokurori është mbajtur parasysh që, pavarësisht mendimit të tij profesional të shprehur, është mbajtur parasysh fuqia detyruese e vendimit të gjykatës dhe janë ndërmarrë veprimet e duhura e të shpejta në këtë drejtim [...].*

4.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, lidhur me këtë procedim penal, vlerëson se hetimi i kërkuar nga Komisioneri Publik u realizua gjatë shqyrtimit të kësaj çështje në Kolegj dhe, në përfundim, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal me nr. *******, të vitit 2016, për kryerjen e veprës penale: “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe vendimi për sekuestron preventive është marrë në zbatim të vendimit nr. ******, datë ****2.2019**, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë.

4.3 Sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive referuar nënindikatorëve të vlerësimit të aftësive të magjistratit, të parashikuara në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e magjistratëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht: (i) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore; (ii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar.

5. *Në lidhje me çështjet që Komisioni ka vendosur t’ia transferojë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore*

5.1 *Procedimi penal nr. *******, datë ****7.2018**, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, regjistruar për kryerjen e veprës penale “Largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal, i pezulluar me vendimin e kësaj Prokurorie në datën ****8.2020**.*

5.1.1 Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka konkluduar³ se: [...] në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionit të administruar në fashikullin penal, vëren se në çështjen objekt hetimi nuk ka treguar përkushtimin e duhur në drejtim të zbardhjes së situatës në kohë, për shkak të rrethanave që e diktonin atë. Subjekti, pasi ka urdhëruar, në datën **.9.2018, delegimin e disa veprimeve hetimore Oficerit të Policisë Gjyqësore, me qëllim zbardhjen e çështjes, nga aktet e administruara në fashikullin penal, ka rezultuar se nuk ka ndjekur në vijimësi kryerjen e tyre... Trupi gjykues, në tërësi, vëren se subjekti nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 [...].

5.2 Procedimi penal nr. ***, datë **.10.2019⁴, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, i regjistruar kallëzimi penal nr. ***/2019, referuar për veprën penale të “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, për të cilin është vendosur mosfillimi i tij.

5.2.1 Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka konkluduar⁵ se: [...] trupi gjykues çmon se kthimi i çështjes për hetime të mëtejshme i atribuon subjektit mungesën e efektivitetit në përmbylljen e fashikullit hetimor në kohë dhe, për pasojë, duket se ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96/2016, i aplikueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale, por edhe të kriterëve të përcaktuara në rregulloren për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. 221, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër kriteret dhe kërkesat e përcaktuara si bazë për vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit është edhe efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale dhe administrimi i një procedimi penal [...].

5.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në lidhje me çështjet që Komisioni ka vendosur t’ia transferojë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, i pranon si të drejta gjetjet e Komisionit, në kuadër të vlerësimit të kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

I. B - Në lidhje me denoncimet e paraqitura pas paraqitjes së ankimit të Komisionerit Publik, të datës 11.11.2021

6. Lidhur me denoncimin e shtetases *** ***, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, Komisioneri Publik ka parashtruar nevojën e hetimit të mëtejshëm në drejtim të verifikimit, nëse është subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, prokurori i çështjes të procedimit penal nr. ***, datë **.3.2019, si dhe veprimet procedurale të kryera.

6.1 Referuar akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr.*** të vitit 2019 rezulton se, në datën **.3.2019, është regjistruar procedimi penal për materialin kallëzues nr. **, datë **.1.2019, të shtetases ***. ***, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

6.2 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datën **.2.2024, regjistruar me nr. **/** prot., lidhur me këtë denoncim, ndër të tjera, është shprehur: [...]

³ Referohuni vendimit të Komisionit në faqet 46-47.

⁴ Referohuni pikës 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionit.

⁵ Referohuni vendimit të Komisionit në faqet 53-54.

Janë kryer disa akte ekspertimi grafik dhe janë kryer pyetjet e ekspertëve në zbatim të vendimeve të gjykatës. Hetimi i këtij procedimi penal është bërë pa shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e ndonjë shtetasi nën hetim, për shkak të mungesës së të dhënave në këtë drejtim, kohës së gjatë të kaluar të prodhimit të dokumentit, që binte gjithsesi në afate parashkrimi të ndjekjes penale [...].

7. *Lidhur me denoncimin e shtetas ******* *******, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, Komisioneri Publik ka parashtruar nevojën në drejtim të verifikimit nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer hetim të gjithanshëm e të plotë, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata.*

7.1 *Referuar akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. ****** të vitit 2020 rezulton se subjekti i rivlerësimit, në datën ******.2.2020, ka regjistruar procedimin penal për materialin kallëzues nr. *******, datë ******.2.2020, me kallëzuese shtetasen *******. *******, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Shtetasja *******. *******. pretendon për falsifikim të vendimit nr. *******, datë ******.9.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Gjirokastrë.*

7.2 *Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datën ******.2.2024, regjistruar me nr. ******/****** prot., lidhur me këtë denoncim, ndër të tjera, është shprehur: [...] Prokurori ka kryer ekspertim grafik të dokumentit, i cili ka rezultuar pa ndërhyrje dhe i punuar në origjinal, por ngelet për t’u vërtetuar nëse ky dokument është prodhuar nga institucionet e kohës dhe punonjësit përkatës, duke i krahasuar me dokumente të ngjashme të asaj periudhe. Objekt i hetimit të jetë edhe kontrata e qiratë të vitit 1949. Lidhur me shtrirjen e hetimit në notat e transkriptimit të vitit 1932 dhe 1937 dhe mbi prona të tjera duhet të kihet parasysh se akti i ekspertimit teknik i kryer, nuk solli prova për falsifikim dokumenti, pasi eksperti përshkroi mënyrën normale të formës e ingranimit të pjesëve të dokumentit. U ekspertua origjinali. Nga na tjetër, për pronën për të cilën është bërë kallëzimi penal, rezulton se janë edhe dy dokumente të tjera mbi të cilat bazohet vendimi i KKKP, Bashkia Gjirokastrë. Në këtë drejtim të kihet parasysh se hetimet janë kryer nën një masë të madhe, se pala i ka mjetet efektive për të rivendosur në vend të drejtën e saj, se çështja ndodhet si në proces penal, ashtu edhe civil. Lidhur me kohëzgjatjen e procedimit rezulton se veprimet janë kryer në kohë, duke patur parasysh edhe gjendjen e jashtëzakonshme të Covid-19, që reduktoi veprimtarinë tonë në një masë të konsiderueshme, për një periudhë kohore të konsiderueshme [...].*

7.3 *Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, lidhur me kohëzgjatjen e hetimit, ka paraqitur shkresat që vërtetojnë ngarkesën, strukturën e kërkesat për shtim organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë.*

7.4 *Edhe në këto dy çështje, si vijim i gjetjeve të përsëritura në këtë gjykim, duket se referuar nënindikatorëve të parashikuar nga neni 74, “Aftësitë organizative”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të cilët shërbejnë në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit, në rastin konkret, gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive në raport me: (i) përballimin e ngarkesës në punë; (ii) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave*

hetimore; (iii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar.

8. Komisioneri Publik çmon të nënvizojë se, në rastin konkret, verifikimi i mangësive në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në raport me përfundimin e procesit të rivlerësimit do të duhet të jetë në harmoni dhe me disa rrethana objektive, të cilat janë provuar edhe gjatë këtij gjykimi, sikundër janë mungesat në organikën e organit të Prokurorisë apo kufizimet e veprimtarisë institucionale për shkak të pandemisë SARS-CoV-2 dhe problematikat që e shoqëruan.

9. Po ashtu, në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e verifikuara në aspektin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit nuk duket të kenë cenuar në tërësinë e saj ushtrimin e ndjekjes penale në emër të interesave shtetërore, sa kohë procedimet penale përkatëse i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor, në disa raste duke u miratuar vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit, në disa të tjera duke plotësuar ky i fundit detyrat e lëna e duke vijuar ushtrimi i ndjekjes penale nën mbikëqyrjen gjyqësore. Mangësitë e vërejtura janë kryesisht të një karakteri organizativ, por që kanë reflektuar në kryerjen e veprimeve jo me efikasitet.

10. Këto konstatime, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, do të duhet të vlerësohen në harmoni edhe me rrethanat e provuara gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, kur ky i fundit, me të drejtë, nuk ka konstatuar problematika të dukshme, që lidhen me dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit.

10.1 Komisioneri Publik, duke çmuar se në tërësi problematikat e konstatuara, lidhen më së shumti me elemente që referojnë në aftësitë organizative të subjektit të rivlerësimit, të parashikuara nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se ato janë të tilla që mund të korrigjohen në kushtet e plotësimit të këtyre mangësive nëpërmjet një programi trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës.

10.2 Ky kërkim i Komisionerit Publik, referuar edhe jurisprudencës së rishtë të Kolegjit, merr në konsideratë faktin se kohëzgjatja 1 (një)-vjeçare e këtij programi trajnues, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, objektivisht, i mundëson Kolegjit, që brenda mandatit të tij kushtetues të rivlerësojë plotësimin e mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit pas përfundimit të programit trajnues, në një seancë gjyqësore publike, ku kompetencat kushtetuese të Komisionerit Publik, sipas parashikimit të paragrafit 8 të nenit 179/b të Kushtetutës, do të ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme (SPAK).

II. Kërkimi përfundimtar

Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 442, datë 14.9.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Çafka.

2. Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Çafka, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

3. Transferimin e çështjeve penale që i përkasin përkatësisht, procedimit penal nr. ***, datë **.7.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, pezulluar me vendimin e kësaj Prokurorie në datën **.8.2020, dhe procedimit penal nr. ***, datë **.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, për të cilin është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore”, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA